



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 790/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.12.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Kufizuar-Marrëveshje Kuadër*”, me nr. REF-31606-07-25-2019, me objekt “*Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit*”, me fond limit 2.800.347.570 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.11.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara”.

Ankimues: Operatori ekonomik “Marsi & Al” sh.p.k.
Rr. “Sami Frashëri”, Pallati Aviacioni i Vjetër, sh. 2, ap. 4, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara
Sheshi “Skënderbej”, nr. 3, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik, pa i hyrë vlerësimit të çështjes *ratione materiae*, vlerëson të ndalet tek respektimi i kërkesave formale (afateve) të ankimimit.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.07.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e Kufizuar-Marrëveshje Kuadër*”, me nr. REF-31606-07-25-2019, me objekt “*Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit*”, me fond limit 2.800.347.570 lekë (pa TVSH).

II.2. Referuar shkresës nr. 9676/1 prot., datë 18.12.2019, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datën 18.12.2019, me nr. 1699/6 prot., me objekt “*Kthim përgjigje*”, konstatohet se në datën 15.10.2019, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike shtojca përkatëse për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, ndërkohë që operatori ekonomik ankimues pretendon se “*më datë 16.10.2019 autoriteti kontraktor ka hequr pezullimin e tenderit në portalin e APP dhe ka bërë publikimin e shtojcës nr. 1 të procedurës së sipërcituar (data e publikimit online të shtojcës mund të jetë edhe pas datës 16.10.2019 por ne e kemi të pamundur ta lexojmë pasi sistemi app.gov.al nuk e nxjerr datën e publikimit për këtë rast specifik prokurimi)*”.

II.3. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor rezulton se, në datën 24.10.2019 Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara ka marrë dijeni për ankesën nr. 1756 prot., datë 22.10.2019 të operatorit ekonomik “Marsi & Al” sh.p.k., në të cilën pretendohet modifikimi i kriterëve të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

Operatori ekonomik ankimues, sqaron se, në datën 22.10.2019 ka depozituar ankesë pranë autoritetit kontraktor (fakt i pranuar dhe nga autoriteti kontraktor në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik).

II.4. Autoriteti kontraktor në dokumentacionin dhe informacionin e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, sqaron se, në datën 01.11.2019, me vendimin nr. 1756/2 prot., datë 30.10.2019 ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, të cilin, sqaron se, ia ka komunikuar zyrtarisht ankimuesit me postë me konfirmim të marrjes njoftim si dhe në rrugë elektronike në adresën elektronike të vendosur prej tij në formularin e ankesës, ndërkohë që autoriteti kontraktor nuk i ka kthyer përgjigje sipas afateve ligjore për trajtimin e ankesës së paraqitur.

II.5. Në datën 01.11.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke pretenduar modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6. Në datën 14.11.2019, nëpërmjet shkresës me nr.1824/1 prot., datë 12.11.2019, me objekt *“Dërgohet informacion për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”*, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentacioni dhe informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Marsi & Al” sh.p.k.

II.7. Në datën 12.12.2019, me shkresën nr. 1699/5 prot., Komisioni i Prokurimit Publik, me objekt *“Kërkesë për informacion”*, i është drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik, si institucioni përgjegjës për sistemin e prokurimit publik, duke kërkuar që në kuadër të shqyrtimit administrativ, i nevojiten datat e publikimit në sistemin e prokurimeve elektronike të të gjithë dokumentacionit të këtij tenderi, ku përfshihen DST, anekset, shtojcat etj.

II.8. Në datën 18.12.2019, me nr. 1699/6 prot., është depozituar pranë institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik shkresa nr. 9676/1 prot., datë 18.12.2019, në lidhje me kërkesën e bërë nga KPP më datë 05.02.2019.

Në këtë shkresë Agjencia e Prokurimit Publik, informon se: [...] *Përsa keni kërkuar, bashkëlidhur po ju vendosim në dispozicion informacionin e kërkuar, konkretisht emërtimin dhe datat e dokumentave të publikuara në sistem nga autoriteti kontraktor për procedurën e sipërcituar.*

Gjithashtu sqarojmë se këto të dhëna nuk ju shfaqen duke qenë se është procedurë e kufizuar dhe është me dy faza [...]”.

Dokumentat e tenderit të ndryshuara 2019-10-15 ...”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në datën 25.07.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e Kufizuar-Marrëveshje Kuadër*”, me nr. REF-31606-07-25-2019, me objekt “*Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit*”, me fond limit 2.800.347.570 lekë (pa TVSH).

III.2. Referuar shkresës nr. 9676/1 prot., datë 18.12.2019, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datën 18.12.2019, me nr. 1699/6 prot., me objekt “Kthim përgjigje”, konstatohet se në datën 15.10.2019, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike shtojca përkatëse për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, ndërkohë që operatori ekonomik ankimues pretendon se “më datë 16.10.2019 autoriteti kontraktor ka hequr pezullimin e tenderit në portalin e APP dhe ka bërë publikimin e shtojcës nr. 1 të procedurës së sipërcituar (data e publikimit online të shtojcës mund të jetë edhe pas datës 16.10.2019 por ne e kemi të pamundur ta lexojmë pasi sistemi app.gov.al nuk e nxjerr datën e publikimit për këtë rast specifik prokurimi).

III.3. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor rezulton se, në datën 24.10.2019 Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara ka marrë dijeni për ankesën nr. 1756 prot., datë 22.10.2019 të operatorit ekonomik “Marsi & Al” sh.p.k., në të cilën pretendohej modifikimi i kritereve të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

Operatori ekonomik ankimues, sqaron se, në datën 22.10.2019 ka depozituar ankesë pranë autoritetit kontraktor (fakt i pranuar dhe nga autoriteti kontraktor në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik).

III.4. Autoriteti kontraktor në dokumentacionin dhe informacionin e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, sqaron se, në datën 01.11.2019, me vendimin nr. 1756/2 prot., datë 30.10.2019 ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, të cilin, sqaron se, ia ka komunikuar zyrtarisht ankimuesit me postë me konfirmim të marrjes njoftim si dhe në rrugë elektronike në adresën elektronike të vendosur prej tij në formularin e ankesës, ndërkohë që ankimuesi pretendon se, autoriteti kontraktor nuk i ka kthyer përgjigje sipas afateve ligjore për trajtimin e ankesës së paraqitur.

III.5. Në datën 01.11.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke pretenduar modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

III.6. Në datën 14.11.2019, nëpërmjet shkresës me nr.1824/1 prot., datë 12.11.2019, me objekt *“Dërgohet informacion për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”*, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentacioni dhe informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Marsi & AI” sh.p.k.

III.7. Në datën 12.12.2019, me shkresën nr. 1699/5 prot., Komisioni i Prokurimit Publik, me objekt *“Kërkesë për informacion”*, i është drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik, si institucioni përgjegjës për sistemin e prokurimit publik, duke kërkuar që në kuadër të shqyrtimit administrativ, i nevojiten datat e publikimit në sistemin e prokurimeve elektronike të të gjithë dokumentacionit të këtij tenderi, ku përfshihen DST, anekset, shtojcat etj.

III.8. Në datën 18.12.2019, me nr. 1699/6 prot., është depozituar pranë institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik shkresa nr. 9676/1 prot., datë 18.12.2019, në lidhje me kërkesën e bërë nga KPP më datë 05.02.2019.

Në këtë shkresë Agjencia e Prokurimit Publik, informon se:

[...]

Përsa keni kërkuar, bashkëlidhur po ju vendosim në dispozicion informacionin e kërkuar, konkretisht emërtimin dhe datat e dokumentave të publikuara në sistem nga autoriteti kontraktor për procedurën e sipërcituar.

Gjithashtu sqarojmë se këto të dhëna nuk ju shfaqen duke qenë se është procedurë e kufizuar dhe është me dy faza [...]”.

Dokumentat e tenderit të ndryshuara 2019-10-15 ...”.

III.9. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr. 9643, dt.20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, në të cilin është parashikuar:

1. *Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*

1.1 *Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.*

2. *Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.*

5. *Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.*

6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.

III.10. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar si edhe parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se ankesa e operatorit ekonomik ankimues “Marsi & Al” sh.p.k. është depozituar pranë autoritetit kontraktor në datën 22.12.2019, e protokolluar me nr. 1756 prot., referuar kjo dokumentacionit të depozituar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Operatori ekonomik ankimues pretendon në ankesën e paraqitur pranë KPP-së se ankesa e depozituar pranë autoritetit kontraktor është bërë në datën 22.12.2019 për modifikimin e dokumentave të publikuara në shtojcën e publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, për të cilën ankimuesi pretendon se “më datë 16.10.2019 autoriteti kontraktor ka hequr pezullimin e tenderit në portalin e APP dhe ka bërë publikimin e shtojcës nr. 1 të procedurës së sipërcituar (data e publikimit online të shtojcës mund të jetë edhe pas datës 16.10.2019 por ne e kemi të pamundur ta lexojmë pasi sistemi app.gov.al nuk e nxjerr datën e publikimit për këtë rast specifik prokurimi).

III.11. Referuar ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se ankimi administrativ pranë autoritetit kontraktor në lidhje me dokumentat e tenderit, i paraqitet së pari me shkrim këtij të fundit brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik, ose në rastin kur ankesa është për modifikimin e dokumentave të publikuara me shtojcat përkatëse, brenda 7 ditëve nga data e publikimit të kësaj shtojce që përmban kriteret që do të ankimohen.

Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor nis që në ditën e publikimit të njoftimit të kontratës/shtojcës (në rastet kur ka siç është rasti konkret) kur ankimuesi është vënë në dijeni dhe është njohur me këto dokumenta, sipas parashikimeve të nenit 63 pika 1.1 të LPP-së.

III.12. Në rastin konkret, Komsioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues nuk ka ezuaruar ankim administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 1.1 të L.P.P.-së. Referuar materialeve të dorëzuara nga operatori ekonomik ankimues, bashkëlidhur ankesës së paraqitur, dokumentacionit dhe informacionit të autoritetit kontraktor si edhe korrespondencës dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Agjencia e Prokurimit Publik, vërtetohet se, shtojca për të cilën ankimuesi ngre pretendime, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike në datën 15.10.2019.

Ashtu siç sqaruam edhe më lart, referuar legjislacionit për prokurimin publik në fuqi, llogaritja e afateve për ankimin pranë autoritetit kontraktor fillon nga dita e publikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit/shtojcës në këtë rast, kur ankimuesi është vënë në dijeni dhe përfundon brenda 7 ditëve.

III.13. Në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSh”, i ndryshuar, parashikohet se: “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i

organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues bashkëngjitur ankesës së depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se, nuk është paraqitur asnjë dokument provues që publikimi i shtojcës për modifikimin e dokumentave të tenderit është publikuar në datën 16.10.2019, madje edhe më pas se kjo datë (referuar pretendimit të tij në ankesë).

III.14. Referuar lex specialis, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se ankimi administrativ pranë autoritetit kontraktor në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, bëhet brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik (në rastin konkret brenda 7 ditëve nga data e publikimit të shtojcës për modifikimin e dokumentave të tenderit, përsa kohë që ankimi i referohet dokumentave të modifikuara të publikuara në këtë shtojcë).

Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor nis që në ditën e publikimit të dokumentave të tenderit, kur operatori ekonomik ankimues është vënë në dijeni.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, operatori ekonomik ankimues nuk e ka ezuaruar ankimin administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 1.1. të L.P.P.-së, pasi ankimi i dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga operatori ekonomik ankimues, duke marrë në konsideratë datën 15.10.2019, referuar kjo informacionit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Agjencia e Prokurimit Publik sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi i prokurimit elektronik, është jashtë afatit të parashikuar nga lex specialis. Sqarojmë se, referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor nis nga dita e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen zyrtare të APP-së ose publikimi i shtojcës përkatëse për modifikim në rastin kur, ankesa i referohet kriterëve të modifikuara të procedurës së prokurimit të publikuara me shtojcë, kur operatori ekonomik ankimues është njohur me këto dokumenta dhe përfundon ditën e shtatë, pra referuar këtij përcaktimi të lex specialis, ankesa duhet të paraqitet nga ankimuesi pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga dita e publikimit të dokumentave të tenderit/shtojcës. Për këtë arsye, ankesa e paraqitur prej operatorit ekonomik ankimues është pas përfundimit të afatit të parashikuar nga neni 63 pika 1.1. të L.P.P.-së, duke mos u legjitimuar racione temporis në dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

III.15. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “Marsi & AI” sh.p.k., nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” që, referuar nenit 26, pikës 3, shkronja “a”, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.16. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marsi & Al” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Kufizuar-Marrëveshje Kuadër*”, me nr. REF-31606-07-25-2019, me objekt “*Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit*”, me fond limit 2.800.347.570 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.11.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së mësipërme të prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1699 Protokolli,

Datë 01.11.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha